

MONITORIMI I TË DREJTËS PËR TUBIME PAQËSORE

Klotilda Kosta
Kostandina Këruçi

2017
2018

SHQIPËRIA

 #right2freeassembly



Autore: Klotilda Kosta dhe Kostandina Këruçi (Partnerët Shqipëri)

Publikuar në Janar 2019

Ky studim u krye si pjesë e projektit rajonal "Monitorimi i të drejtës për tubime paqësore", i menaxhuar nga Qendra Evropiane për Ligjin Jo-fitimprurës (ECNL). Projekti është bërë i mundur nga Qendra Ndërkombëtare për Ligjin jofitimprurës (ICNL) përmes Iniciativës Hapësinore Qytetare.



Ky raport financohet tërësisht nga Qeveria Suedeze. Qeveria Suedeze jo domosdoshmërisht ndan mendimet e shprehura në përmbajtje të këtij raporti. Autori mban përgjegjësinë e vetme për përmbajtjen.

Copyright © 2019 nga Qendra Evropiane për Ligjin Jo-fitimprurës dhe Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

(Foto e kopertinës është mundësuar nga Alamy - <https://bit.ly/2z5JzMf>, fotot në botim janë mundësuar nga Unsplash)

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
II. SITUATA E PËRGJITHSHME	7
III. KUADRI LIGJOR	10
IV. ADMINISTRIMI I TË DREJTËS PËR TUBIME	15
<i>Rast Studimor</i>	19
V. MBIKËQYRJA E TUBIMEVE	21
Media dhe Tubimet	23
VI. KRIMINALIZIMI I PROTESTAVE	26
VII. REKOMANDIME	31
REFERENCA	33



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

E drejta për të organizuar dhe marrë pjesë në një tubim paqësor është një e drejtë kushtetuese që garanton të drejtën e individit për t'u organizuar për çdo qëllim legjitim. Në përgjithësi, kuadri ligjor dhe rregullator në Shqipëri është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe e mundëson këtë të drejtë në praktikë. Megjithatë ai ka nevojë për përmirësime, të cilat duhet të qartësojnë "njoftimet" përkundrejt "kërkesës"/ "lejes", të drejtën për tubime spontane dhe kundër – tubime si dhe krijimin e formateve të njoftimit online për të mundësuar kryerjen e procedurës së njoftimit përmes internetit. të cilat janë pjesë e standardeve ndërkombëtare, por që mungojnë në legjislacionin aktual.

Policia e Shtetit është autoriteti kryesor publik i cili siguron rendin dhe sigurinë publike gjatë organizimit të tubimeve. Nevoja kryesore për përmirësim nga Policia e Shtetit në lidhje me tubimet, siç dëshmohet edhe nga dy raportet e monitorimit (Raporti i Tubimeve 2016-2017 dhe Raporti i Tubimeve 2017-2018) është publikimi online i formateve standarde për njoftim dhe komunikim me organizatorët e tubimeve, me qëllim rritjen e qasjes, transparencës dhe lehtësimin e procedurave për të mundësuar

ushtrimin e kësaj të drejte themelore nga qytetarët. Përveç kësaj, nevojitet trajnim i vazhdueshëm i policëve për vëzhgimin e tubimeve.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë gjithashtu disa përgjegjësi për të siguruar rendin publik. Praktika tregon se përveç Ligjit për Tubimet, disa bashki miratojnë rregullore të brendshme për të siguruar rendin publik gjatë tubimeve, ndërsa disa të tjerë luajnë një rol të ndërmjetëm midis organizatorëve dhe autoriteteve policore në rastet kur organizatorët dërgojnë njoftime për organizim tubimi tek bashkitë. Është e rëndësishme që rregulloret vendore të jenë në përputhje me Ligjin për Tubimet dhe të mos paraqesin pengesa për qytetarët që të ushtrojnë të drejtën e tyre për tubim.

Institucioni i Avokati i Popullit ka luajtur një rol proaktiv përmes adresimit të një sërë rekomandimesh tek autoriteti i policisë së shtetit në lidhje me tubimet, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.

Rekomandimet lidhen me standardizimin e procedurave të njoftimit për organizimin e tubimeve, publikimin online të procedurës së njoftimit dhe publikimin online dhe vënien në dispozicion të formateve për qytetarët për të paraqitur njoftimin online për organizimin e një tubimi. Ky është një zhvillim pozitiv që do të mundësonte gjerësisht të drejtën për t'u organizuar dhe për të marrë pjesë në tubim paqësor. Megjithatë, kërkohet bashkëpunim dhe koordinim më i mirë midis institucioneve publike.

Sa i përket kriminalizimit të protestave, ka pak raste të raportuara nga gjykatat e rretheve mbi tubimet. Kryesisht rastet janë nga autoritetet publike përkundër organizatorëve të tubimeve. Vendimet gjyqësore përfundojnë me gjoba, kundër organizatorëve. Gjobat variojnë nga 50,000 lekë (400 EUR) në 60,000 lekë (480 EUR).

Media dhe media sociale janë mjete të rëndësishme për të shpallur thirrje për organizimin e tubimeve, për të mobilizuar njerëzit dhe për të ndërtuar mbështetje për kauzën. Megjithatë, mediat duhet të punojnë më shumë në hetimin e tubimeve.



II. SITUATA E PËRGJITHSHME

Sikundër raportit të "Monitorimin e të Drejtës për Tubime Paqësore 2016 – 2017" mungojnë të dhënat publike mbi numrin, natyrën dhe shpërndarjen gjeografike të tubimeve të organizuara gjatë periudhës 2017 - 2018. Shifrat e cituara në këtë raport janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si përgjigje ndaj kërkesës për informacion të dërguar në bazë të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Nga përgjigja zyrtare e marrë, tek strukturat e policisë vendore janë paraqitur 1,274 njoftime për organizimin e tubimeve për periudhën e monitorimit që mbulon ky raport. Të ndarë sipas viteve, shumë tubime janë organizuar gjatë vitit 2017, respektivisht 1,060 tubime dhe 214 tubime janë organizuar gjatë tetë muajve të parë të vitit 2018. Numri i lartë i tubimeve të organizuara gjatë vitit 2017 lidhet me organizimin e Zgjedhjeve Parlamentare dhe shumë tubime janë organizuar në këtë kontekst politik. Krahasuar me raportin e mëparshëm të tubimeve, ka një rënie të lehtë të njoftimeve për organizimin e tubimeve, nga 1,369 tubime në 1,274 njoftime.

Përveç tubimeve të organizuara në kuadër të fushatës zgjedhore të vitit 2017, shumica e tubimeve janë organizuar në formën e protestave, respektivisht 284 protesta, ndjekur nga 13 marshime, 4 demonstrata dhe 9 forma të tjera organizimi.

Lidhur me vendndodhjen gjeografike, tubimet organizohen dhe mbahen në vendet ku trajtohet çështja në fjalë, qofshin zona urbane apo rurale. Megjithatë, një numër i lartë i tyre organizohen në Tiranë, sepse shumë institucione publike janë në kryeqytet.

Natyra e tubimeve është e ndryshme si në çështjet, ashtu edhe në problemet që adresojnë. Në përgjithësi, ato udhëhiqen nga pakënaqësia ndaj qeverisë dhe performancës së institucioneve publike. Tubimet e organizuara kanë natyrë politike, sociale, ekonomike, kulturore dhe mjedisore. Disa tubime kanë fituar vëmendje publike dhe mediatike për shkak të natyrës së tyre "të ndjeshme" që trajtojnë. Për ta ilustruar më konkretisht, mund të përmendim protestën e artistëve shqiptarë kundër prishjes së ndërtesës së teatrit, protestat kundër vendimit të qeverisë për koncesionet në Luginën e Valbonës dhe Luginën e Vjosës, demonstrata e banorëve në veri të Shqipërisë kundër vendimit për koncesion për mirëmbajtjen e Rrugës së Kombit, etj.

Gjatë vitit 2017 – 2018 policia e shtetit refuzoi 21 njoftime për organizimin e tubimeve; ndërkohë që ka pasur vetëm një rast kur policia e shtetit ka vendosur kufizime.

Arsyet janë si më poshtë:

1. Njoftimi nuk ishte në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin për Tubimet;
2. Ndërhyrja në trafik dhe bllokimi i mjeteve të transportit, sepse tubimet u organizuan në rrugët kryesore;
3. Angazhimi i punonjësve të policisë / strukturave në shërbime të tjera gjatë sezonin turistik veror;
4. Organizimi dhe pjesëmarrja në tubime dhe manifestime të paligjshme;
5. Njoftimi është kthyer për t'u plotësuar me informacione të tjera.

Pikat 2 dhe 3 janë në kundërshtim me Ligjin për Tubimet, pasi Policia e Shtetit duhet të garantojë dhe të mbrojë të drejtën e secilit individ për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime paqësore, dhe të marrë masa për të mbrojtur këtë të drejtë në hapësirat publike dhe në vendkalime. Megjithatë, sikundër edhe në Raportin e Monitorimit të Tubimeve 2016 – 2017 Policia e Shtetit theksoi se tubimet e ndaluara u organizuan gjithsesi. Në disa prej këtyre rasteve, në bazë të hetimeve të kryera nga Avokati i Popullit, policia ka shpërndarë protestuesit me forcë dhe/ose ka kallëzuar në prokurori për të nisur hetime kundër organizatorëve dhe pjesëmarrësve në këto protesta për veprën penale "organizimi dhe pjesëmarrja në tubime dhe manifestime të paligjshme", parashikuar në nenin 262 të Kodit Penal. Bazuar në informacionet nga Gjykatat e Qarkut në Berat, Fier dhe Shkodër, ka raste kur organizatorët janë sanksionuar me gjoba për organizimin e tubimeve të ndaluara nga Policia e Shtetit.

Referuar tubimeve me përshkallëzim dhune, 7 tubime kanë përfunduar me dhunë dhe përplasje mes pjesëmarrësve dhe policisë. Në tubimin e organizuar më 31.03.2018, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe banorët e Zonës së Veriut të Shqipërisë kundër vendosjes së taksave të reja që u imponohen shoferëve në degën kryesore të Rrugës së Kombit midis Shqipërisë dhe Kosovës, 37 pjesëmarrës në tubim u arrestuan dhe u dërguan në Komisaratin e Policisë bazuar në një urdhër të paraburgimit lëshuar nga zyra e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. Policia e Shtetit deklaroi se oficerët e policisë nuk përdorën asnjë forcë ndaj organizatorëve dhe pjesëmarrësve në tubim, por mediat dhe përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore të rajonit verior deklaruan të kundërtën.

Në përgjithësi, vlerësimi i përgjithshëm i viteve të fundit, rreth të drejtës për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime paqësore është pozitiv. Duhet të theksohet fakti që të rinjtë janë më të angazhuar dhe kanë marrë pjesë në një tubim apo peticion kur arsyeja kryesore për të marrë pjesë ka qenë e lidhur për interesin të përbashkët për komunitetin që i përket (IDM, 2018). Krahasuar me katër vite më parë, situata është përmirësuar sa i përket administrimit të tubimeve, mirëmbajtjes së rendit publik gjatë tubimeve dhe respektimit të lirisë të tubimeve.

Megjithëse kjo e drejtë është mundësuar në një shkallë të lartë, ka ende hapësirë për përmirësim në aspektin e kuadrit ligjor dhe rregullator për tubimet, koordinimin ndërmjet autoriteteve publike përgjegjëse për mbrojtjen dhe administrimin e tubimeve paqësore, ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët publikë përgjegjës për administrimin e tubimeve; si dhe rritjen

e llogaridhënies në lidhje me veprimet nga institucionet publike.

III. KUADRI LIGJOR



Në Shqipëri, liria për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime paqësore është një e drejtë kushtetuese që garanton të drejtën e njerëzve për t'u organizuar për çdo qëllim legjitim. Krahas kësaj, kjo e drejtë rregullohet përmes ligjit "Për Tubimet", "Kodi Penal të Republikës së Shqipërisë" dhe Ligji "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar.

Gjatë periudhës 2017 – 2018 nuk pati ndryshime ligjore për tubimet. Ligji për Tubimet konsiderohet "**një ligj me frymë pozitive**", në përputhje me të drejtat dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi. Ai garanton të drejtën që çdo qytetar të organizojë dhe marrë pjesë lirisht në tubime paqësore, për të shprehur kërkesat dhe pikëpamjet e tyre për problemet apo çështjet që u interesojnë.

Ligji për Tubimi njih organizimin e tre lloj tubimesh, si më poshtë:

1. Tubime në sheshe ose në vendkalime publike;
2. Tubime të organizuara në vende të hapura për publikun. Sipas përkufizimit të Ligjit, "vend i hapur për publikun" është një vend në dispozicion të personave të tjerë që mund të vendosin kushte për të lejuar hyrjen në të apo jo (p.sh. stadione, dhoma kinemaje, teatro etj.); dhe,

3. Tubime të organizuara në zona private.

Përveç kësaj, Ligji njih "tubime urgjente", kur tubimet janë organizuar për shkak të rrethanave urgjente.

E drejta për tubim paqësor nuk është një e drejtë absolute. Kufizimi mbi këtë të drejtë ndodh në rastet kur rrezikohet siguria kombëtare, siguria publike, mbrojtja e rendit dhe parandalimi i krimit, ruajtja e shëndetit dhe moralit, apo mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut. Përveç kësaj, Ligji¹ përcakton ndalimin e çdo mjetei apo instrumenti gjatë tubimeve, përdorimi i të cilave mund të shkaktojë dëmtime për jetën dhe shëndetin e të tjerëve; përdorimi i uniformave, shenjave ose simboleve që u referohen grupimeve që nxisin diskriminimin dhe dhunën për arsye racore, etnike ose fetare; dhe është e ndaluar të marrësh pjesë në një tubim duke përdorur sende ose veshje me qëllim fshehjen e identitetit.

Organizatorët e tubimeve duhet të caktojnë një lider/ drejtues dhe personat ndihmës. Sipas Ligjit për Tubimet, lideri dhe personi ndihmës janë përgjegjës për planifikimin, mbarëvajtjen e tubimit gjatë dhe përfundimin të tij.

¹Idem, neni 18, 19, dhe 20

"Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm"

Neni. 46, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

"Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe pjesëmarrja në to është e garantuar. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj"

Neni. 47, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Është në përgjegjësinë e liderit dhe personave ndihmës të tij që të japin urdhër që pjesëmarrësit në tubim të ruajnë rendin publik dhe nëse nuk i përgjigjen urdhrave të tij / saj, lideri ka autoritetin të ndërpresë dhe mbyllë tubimin.

Duke iu referuar njoftimit, organizatori i një tubimi duhet të njoftojë me shkrim strukturën e policisë vendore dhe të japë informacion mbi tubimin që do të zhvillohet. Ligji "Për Tubimet" njih Strukturën e Policisë së Shtetit si autoritet që ka fuqi vendim-marrëse për organizimin e një tubimi. Megjithatë, terminologjia e përdorur në Ligjin "Për Tubimet" është konfuze dhe ç'orientuese, pasi në disa nene shprehet se organizatorët e një tubimi duhet të dërgojnë një "njoftim me shkrim", ndërsa në nenin 6 përmendet "kërkesë".² Përveç kësaj, në nenin 261 "Organizimi dhe pjesëmarrja në tubime të paligjshme" të Kodit Penal përdoret termi "leje". Kjo çon në konfuzion nëse është vetëm një njoftim me shkrim ose një autorizim nga autoritetet për të garantuar tubimin.

Një aspekt tjetër që ka nevojë për përmirësim tek "Ligji "Për tubimet" ka të bëjë me organizimin e tubimeve spontane dhe kundër - tubimet. Ligji nuk njih asnjërin prej tyre. Për më tepër, në nenin 2 ligji përcakton që "*kur grupe njerëzish mbledhen në mënyrë spontane dhe nuk shkelin rendin publik, aktiviteti i tyre nuk konsiderohet tubim*". Si rezultat, nuk ka asnjë garanci që strukturat e policisë së shtetit do t'i lejojnë apo garantojnë siguri gjatë organizimit të tyre.

²Idem, neni 6: Policia e shtetit pasi merr "kërkesën" me vendim të arsyetuar duhet të komunikojë t'i komunikojë organizatorit ose drejtuesit të tubimit ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij ose t'u japë një kopje të urdhrat zyrtar për caktimin e oficerit të policisë që do të jetë përgjegjës për të ndihmuar e vëzhguar zhvillimin e tubimit.

Misioni i strukturave të Policisë së Shtetit është ruajtja e rendit dhe sigurisë publike, duke garantuar zbatimin e kuadrit ligjor.³ Sidoqoftë, kuadri ligjor nuk parashikon ndonjë angazhim nga ana e Policisë së Shtetit që konsiston në takime, negociata apo komunikime me organizatorët gjatë të gjitha fazave të organizimit të tubimit.

Policia mund të regjistrojë zëra dhe të bëjë video ose fotografi gjatë organizimit të tubimeve në sheshe dhe vendkalime publike, ose në vende të hapura për publikun, vetëm në rastet kur besohet se ekziston mundësia e një rreziku ndaj rendit dhe sigurisë publike. Nëse ka evidenca për shkeljen e rendit publik, punonjësit e policisë të emëruar për të ndihmuar dhe për të vëzhguar tubimin mund të urdhërojnë organizatorët të ndalojnë tubimet dhe të largohen menjëherë nga vendi i mbledhjes.⁴ Regjistrimet, filmat dhe fotografitë do të shkatërrohen menjëherë pas përfundimit të tubimit nëse nuk janë të nevojshme për këto dy qëllime:

të nis një proces penal për pjesëmarrësit; për të parandaluar një rrezik, kur besohet se personi i filmuar në të ardhmen mund të kryejë vepra penale lidhur me tubimet.⁵

Punonjësi i policisë përgjegjës për tubimin mund të urdhërojë shpërndarjen e tubimit me forcë pas tre "thirrjeve të pasuksesshme" të pjesëmarrësve për t'u larguar. Sipas Ligjit për Tubime, në çdo rast të shpërndarjes, përdorimi i forcës duhet të jetë gjithmonë i kufizuar në një minimum.⁶

³Neni 2 i Ligjit Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit"

⁴Neni 21, sesioni 1, Ligji Për Tubimet

⁵Idem, neni 21, sesioni 2

⁶Idem, neni 21, sesioni 2

Lidhur me sanksionet, Ligji "Për Tubimet" parashikon sanksione për katër lloje të kundravajtjeve penale. Për pjesëmarrjen në tubimet e ndaluara (1) dhe mos përgjigjes së urdhrave të punonjësve të policisë (2) për të shpërndarë tubimin, ka sanksione me gjoba që variojnë nga 1000 Lekë (rreth 7.5 EUR) deri në 10 000 Lekë (rreth 75 EUR). Duke iu referuar përdorimit të sendeve dhe veshjeve me qëllim fshehjen e identitetit të pjesëmarrësve (3) dhe përdorimin e uniformave, shenjave apo simboleve që u referohen shoqatave ose grupimeve që nxisin diskriminimin dhe dhunën për arsye racore, etnike ose fetare (4), sanksionohen me gjoba ose me burgim deri në gjashtë muaj. Lidhur me gjobat, Ligji nuk parashikon ndonjë varg masash për rastet e mësipërme.

Përveç kësaj, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë përcakton sanksione të tjera. Për organizimin e tubimit pa leje nga organet e autorizuar, organizatorët gjobiten me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Për pjesëmarrjen në një tubim të paligjshme, Kodi Penal parashikon sanksione me gjoba deri në tre muaj burgim. Në rastet kur përsëritja e kundravajtjes, sanksionet ndryshojnë nga gjobat deri në dy vjet burgim. Përsëri, shuma e gjobave nuk parashikohet në Kodin Penal. Sikundër është cituar edhe në raportin e mëparshëm të "Monitorimit të së Drejtës për Tubimet 2016 – 2017" sanksionet e parashikuara në kuadrin ligjor nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në rastet kur organizatorët janë të pakënaqur me vendim marrjen e strukturave të Policisë së Shtetit, ata mund të apelojnë vendimin.⁷ Megjithatë, Ligji është shumë i gjerë për sa i përket apelimit, duke deklaruar vetëm se apelimi duhet të bëhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi. Nuk është përcaktuar se si duhet të bëhet ankimi, kur, cili është autoriteti ku paraqitet ankesa dhe kur duhet të merret vendimi për të mundësuar kryerjen e një tubimi.

Gjatë periudhës së monitorimit nuk pati nisma për ndryshimin e kuadrit ligjor ekzistues. Një zhvillim pozitiv, që pasqyron edhe rekomandimet e dhëna në raportin e mëparshëm të "Monitorimit të së Drejtës për Tubimet 2016 – 2017" është gatishmëria e policisë së shtetit për të reflektuar një set rekomandimesh të ofruara nga Avokati i Popullit mbi përgatitjen e formateve që lidhen me tubimet dhe publikimin e tyre online.

⁷Idem, neni 25



IV. ADMINISTRIMI I TË DREJTËS PËR TUBIME

Në Shqipëri, Policia e Shtetit është struktura kryesore përgjegjëse për administrimin e tubimeve, për dorëzimin e njoftimeve për organizimin e tubimeve dhe për përcaktimin e kufizimeve ose ndalimin e tyre. Për tubimet e organizuara në sheshe dhe vendkalime publike, si dhe tubimet urgjente, organizatorët janë të detyruar të njoftojnë me shkrim për organizimin e një tubimi.

Për llojet e tjera të tubimeve, organizatorët nuk janë të detyruar të dërgojnë një njoftim me shkrim, por mund t'i kërkojnë Policisë së Shtetit t'i mbështesin kryerjes së tubimit. Në rastet e tubimeve të organizuara në vende të hapura për publikun, oficeri i policisë duhet t'i mbështesë ato jashtë vendit ku organizohet tubimi. Në rastet e tubimeve të organizuara në zona private, policia nuk mund të hyjë pa lejen e organizatorit të tubimit ose pronarit të zonës private, me përjashtim të rasteve flagrante për të parandaluar rrezikun për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve.

Njoftimi me shkrim për organizimin e tubimit duhet të dorëzohet jo më vonë se tri ditë para datës së organizimit. Letra e njoftimit duhet të përmbajë këto elementë:

- Numri i përafërt i pjesëmarrësve dhe numri i personave ndihmës për kryerjen e tubimit;
- Personat që do të flasin në tubim.

- Identiteti dhe adresat e organizatorit dhe drejtuesit të tubimit;
- Qëllimi i tubimit;
- Datën, vendin, orën e fillimit dhe mbarimit dhe itinerarin e tubimit;

Në rastet e tubimeve urgjente, letra e njoftimit me shkrim duhet të dorëzohet 3 orë para tubimit. Letra e njoftimit, përveç elementeve të mësipërme, duhet të përmbajë arsyen për urgjencën e saj.

Njoftimi i dorëzohet Zyrës së Shërbimit për Qytetarët (ZSHQ)⁸ të strukturës vendore të Policisë. ZSHQ transferon njoftimin tek Shefi i Komisarariatit të Policisë që ka nën juridiksionin e tij vendin ku do të organizohet tubimi. Në rastet kur itinerari i një tubimi përfshin më shumë se një komisarariat, njoftimi i dërgohet të gjitha komisariateve të përfshira.

Policia e Shtetit duhet të japë vendimin brenda 24 orëve pas pranimit të informacionit të plotë. Në rastet kur organizatorët nuk dorëzojnë të gjithë informacionin përkatës, organi i autorizuar i kërkon ta përfundojë atë. Rishikimi i informacionit të plotë nuk duhet të jetë më vonë se 24 orë para fillimit të tubimit.⁹ Në këtë rast, vendimi merret brenda 8 orëve nga paraqitja e kërkesës.

⁷Informacioni është marrë nga faqja e internetit të Policisë së Shtetit https://www.asp.gov.al/images/njoftime-deklarime/njoftim_tubimi.pdf

⁸Neni 5, sesioni 3, Ligji për Tubimet

Sipas Ligjit për Tubimet, Shefi i Komisarariatit të Policisë njofton Bashkinë dhe Prefektin nëpërmjet njoftimit me shkrim për organizimin e tubimit.¹⁰ Zbatimi i kësaj procedure në praktikë, konfirmohet edhe nga përfaqësuesit e bashkisë, gjatë intervistave të kryera me ta. Ata nuk luajnë rol për administrimin e tubimeve pasi Ligji "Për Tubime" i jep autoritetin kryesor Policisë së Shtetit.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk kanë detyrim ligjor të takohen me organizatorët e tubimit. Rastet e vetme kur ata kanë të drejtë të thërrasin organizatorët e tubimit janë kur prona publike është dëmtuar për shkak të përplasjeve dhe shkeljeve që kanë ndodhur gjatë organizimit të një tubimi. Në këto raste, njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me policinë e shtetit për të dokumentuar shkeljen e pronës publike dhe për të vendosur gjoba në përputhje me taksat vendore. Ndërsa përfaqësuesit e bashkisë thanë se Policia Bashkiake nuk ka rol gjatë organizimit të tubimeve, sipas nenit 8 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Bashkiake, policia bashkiake duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e rendit publik, në vende ku njerëzit mblidhen si tregje, panairë, në ceremoni publike, artistike, fetare, atletike, në kinema, teatro, ndërtesa atletike dhe salla dhe mjedise të tjera publike.¹¹

Sipas Ligjit "Për tubimet", organizatorët e tubimeve duhet të dorëzojnë njoftimin vetëm tek Policia e Shtetit, si struktura kryesore për administrimin e tubimeve. Sidoqoftë, në praktikë vërehet se në disa raste organizatorët e dorëzojnë njoftimin edhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Nuk ka procedura të unifikuara, por ato variojnë nga Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

¹⁰Idem

¹¹<http://www.vendime.al/wp-content/uploads/2015/08/LIGJI-Nr.-8224-dat%C3%AB-15.5.1997P%C3%8BRORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-POLICIS%C3%8BT%C3%8B-BASHKIS%C3%8B-DHET%C3%8BKOMUN%C3%8BS.pdf>

Sipas Bashkisë së Tiranës, vendimmarrja për organizimin e tubimeve bëhet në përputhje me Ligjin për Tubimet dhe në përputhje me Urdhrin nr. 10663¹² të Bashkisë së Tiranës. Kapitulli VI i Urdhrit parashikon përdorimin e hapësirave publike për zhvillimin e aktiviteteve artistike, kulturore, promovuese, manifestimeve politike etj.

Sipas këtij dokumenti, subjekti që kërkon të zhvillojë aktivitete të tilla në hapësirat publike të Bashkisë duhet të pajiset me lejen përkatëse të lëshuar nga Bashkia¹³, bazuar në kërkesën e paraqitur në Qendrën së Regjistrimit të Licencave Tiranë.¹⁴ Kërkesa duhet të dorëzohet 25 ditë para organizimit të aktivitetit, dhe në rastet urgjente, kërkesa duhet të dorëzohet 7 ditë më parë. Siç vërehet, afati kohor i përcaktuar në Urdhrin e Bashkisë së Tiranës, në rastet e tubimeve (manifestimeve politike) nuk është në përputhje me afatin kohor të përcaktuar në Ligjin për Tubimet (tre ditë para mbledhjes), duke limituar këtë të drejtë.

Të pyetur për lejet e dhëna për tubimet e organizuara në 2017 - 2018, përgjigja e Bashkisë së Tiranës është si vijon:

1. Gjatë vitit 2017, Bashkia e Tiranës ka dhënë gjithsej 6 leje për organizimin e tubimeve, nga të cilat 2 kishin natyrë politike dhe 4 ishin marshime, duke pasur natyrë ndërgjegjësuere.
2. Gjatë vitit 2018, Bashkia e Tiranës ka dhënë gjithsej 7 leje për organizimin e tubimeve, nga të cilat 2 kishin natyrë politike dhe 5 ishin marshime, duke pasur natyrë ndërgjegjësuere.

¹²Urdhër. Nr. 10663, datë 21.03.2017, "Disa ndryshime dhe shtesa në Urdhëresën e Kryetarit nr.25850, datë 26.08.2016 për "Rregullat dhe kushtet e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës"" <http://www.tirana.al/publimedpdf/rregullorja.pdf>

¹³Idem, neni 66, pika 1

¹⁴Idem, neni 66, point 3

Të pyetur mbi tubimet e ndaluara, Bashkia e Tiranës deklaroi se nuk ka lëshuar urdhër për ndalimin e organizimit të tubimeve. Gjatë intervistave me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) që kanë organizuar tubime në Tiranë shprehën se nuk i kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në Urdhër. Ata u shprehën se përfaqësuesit e policisë bashkiake i kanë plotësuar nevojat e OShC-ve në vendosjen e pajisjeve për organizimin e tubimeve, madje pa dorëzuar njoftimin në Bashkinë e Tiranës.

Përfaqësuesi i Bashkisë Berat, u shpreh se Bashkia nuk ka ndonjë rregullore të brendshme për organizimin e tubimeve. Megjithatë, në shërbimin One Stop Shop si pjesë e Bashkisë, qytetarët kanë depozituar kërkesë për organizimin e tubimit. Në këto raste, Bashkia ka luajtur rolin e ndërmjetësuesit dhe ka informuar zyrtarët e policisë që të marrin masa për mbrojtjen e rendit dhe për të komunikuar me organizatorët. Në bashkinë e Shkodrës nuk ka raste të njoftimeve të dorëzuara në bashki gjatë vitit 2017-2018, dhe asnjë informacion me shkrim nga policia mbi tubimet e organizuara në territorin e bashkisë.

Sa i përket procesit të monitorimit në lidhje me tubimet, Zyra e Avokatit të Popullit në Shqipëri luan një rol të rëndësishëm. Ky autoritet ka të drejtë të mbikëqyrë me kujdes proceset dhe procedurat, të marrë ankesa dhe të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.¹⁵

¹⁵Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 63, paragrafi 3.

Gjatë periudhës së monitorimit, Zyra e Avokatit të Popullit ka luajtur një rol aktiv në monitorimin e kësaj të drejte dhe nxjerrjen e rekomandimeve për strukturat shtetërore. Ai ka nxjerrë dy rekomandime për Policinë e Shtetit për kryerjen e tubimeve të bazuara në dy protestat e organizuara në vitin 2018, (i) protestën e Kukësit të organizuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe banorët e veriut kundër taksave të reja të vendosura për rrugën nacionale dhe (ii) protestën e organizuar nga Lëvizja Rinore Rome dhe Egjiptiane për vdekjen e një të riu në ambientet e Komisarariatit të Policisë së Korçës.

1. Protesta e Kukësit u organizua më 31 mars 2018, dhe një nga organizatorët e protestës ishte Këshilli Bashkiak i Kukësit. Duke respektuar Ligjin për Tubimet, tre ditë para organizimit të tubimit, ata dorëzuan njoftimin në Komisariatin e Policisë së Kukësit. Por, 48 orë pas marrjes së njoftimit, Shefi i Komisarariatit të Kukësit i dërgon një letër Këshillit Bashkiak për informacione të mëtejshme, të cilat mungonin në letrën e njoftimit, siç është numri i prituri të protestuesve dhe emrat nominalë të persona që do të flasin. Përveç kësaj, vendi për organizimin e tubimit konsiderohej i papërshtatshëm, për shkak të pengesës së rrugës për mjetet e transportit dhe qytetarët. Brenda të njëjtës ditë, u organizuan dy takime mes dy palëve për organizimin e tubimit. Këshilli Bashkiak në 24 orët e fundit ridërgoi letrën e njoftimit, duke përmbushur kërkesat e policisë. Në të njëjtën kohë, siç u vërejt dhe u shpreh nga Avokati i Popullit, Shefi i Komisarariatit të Kukësit nuk ndërmori vendim administrativ për ndalimin e tubimit ose për emërimin e kohës dhe vendit për organizimin e kuvendit, siç pretendonte Shefi i Komisarariatit.

Përveç kësaj, ai ka tejkeluar afatin kohor të parashtruar në ligj për t'iu përgjigjur njoftimit brenda 24 orëve, duke i lënë më pak kohë organizatorëve të përmbushin elementet e njoftimit.

2. Rasti i dytë është vdekja e një qytetari të ri rom në ambientet e dhomës së paraburgimit në Komisarlatin e Policisë së Korçës. Lëvizja Rinore Rome dhe Egjiptiane, një organizatë e shoqërisë civile, ka shpërndarë informacionin për organizimin e një tubimi para Ministrisë së Brendshme për të protestuar për vdekjen e djalit të ri dhe ka ftuar grupe dhe qytetarë të tjerë që të bashkohen me ta. Drejtorja e Policisë së Tiranës ka ndaluar kryerjen e tubimit me pretendimin se kërkesa është dërguar një orë para organizimit të tubimit dhe nuk ishin përfshirë të gjithë elementet (afati kohor për dorëzimin e njoftimit, identiteti dhe adresa e organizatorit dhe administratori të tij, dhe emri i folësve) sipas ligjit janë pasqyruar në kërkesën e paraqitur. Pas monitorimit nga Avokati i Popullit rezultoi se kërkesa është dërguar tri ditë para organizimit të tubimit me postë dhe veprimet e strukturës së policisë nuk janë në përputhje me Ligjin për Tubimet.

RAST STUDIMOR

ZHVILLIM POZITIV: STANDARDIZIMI DHE PUBLIKIMI I PROCEDURAVE MBI NJOFTIMET PËR ORGANIZIMIN E TUBIMEVE

